



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 648/4 Prot

Tiranë, më 29 07.2016

VENDIM

Nr. 51, datë 29.07.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr. 145, datë 03.06.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 08.06.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri nga kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë, gjatë kryerjes së veprimtarisë të tij në fushën e arsimit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.145, datë 03.06.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi ka një rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e DAR-Lezhë, por nuk ka një rregullore specifike për mbrojtjen e të dhënave personale;
2. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit "Deklaratën e Konfidencialitetit";
3. Nga verifikimi i bërë në tre shkolla të ndryshme, konstatohet se, në gjimnazin "Hydajet Lezha" është vendosur një sistem video-vëzhgimi (CCTV), por në hyrje të ambienteve nuk konstatohen tabelat informuese mbi prezencën e këtij sistemi sipas Udhëzimit Nr. 3 të Komisionerit.

4. Konstatohet se në portalin e kontrolluesit, www.darlezhe.arsimi.gov.al, krahas rezultateve të testimit të mësuesve nëpërmjet tabelës, sipas modelit standard të kërkuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve, janë publikuar ID-ja e aplikantit, pikët, nr. personal (ID-ja unike) e subjektit të të dhënave, gjinia, lënda etj.

Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 27 dhe 28 të Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Nr. 9887/2008.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

- Rregullore për funksionimin e Drejtorisë Arsimore Lezhë;
- Fotografi nga ambientet e gjimnazit “Hydajet Lezha”;
- Urdhër Nr.76 datë 19.02.2013 për legalizimin e dokumentave zyrtare të arsimit parauniversitar në ministrinë e arsimit dhe shkencës;
- Tabela e vlerësimit të testit të mësuesve, publikuar në portalin e DAR-Lezhë;
- Udhëzimi Nr.30 datë 02.08.2013 për rregulloren e institucioneve Arsimore;
- Komunikim nëpërmjet postës elektronike (adresa personale e nëpunësve të DAR Lezhë), në lidhje me publikimin e tabelës me të dhënat e mësuesve të cilët kanë kryer testimin.

Në zbatim të kërkesave të Urdhrit Nr.145 të Komisionerit, në datë 08.06.2016, hetimi administrativ u shtri dhe pranë tre shkollave të qytetit: Gjimnazi “Hydajet Lezha”, shkollat 9-vjeçare “Besëlidhja” dhe “Gjergj Fishta”, si dhe u mbajt procesverbali nga ana e grupit të kontrollit, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë*, rreth të cilit nuk pati pretendime.

Në këto shkolla më tepër vëmendje ju kushtua rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, të nxënësve me probleme sociale, nxënësve me probleme të shëndetit mendor, dhe nxënësve problematikë në sjellje. Përveç dosjes mësimore që hapet si për gjithë nxënësit e tjerë, mbahej dosje e veçantë, në të cilën hidhen të dhënat reaguese të nxënësit vulnerabël, apo dhe përshkrimi i sjelljes së nxënësit problematik. Në këtë dosje kishte akses vetëm mësuesja, psikologja të cilës i bëheshin me dije sjelljet e nxënësit, drejtori i shkollës, si dhe institucionet që kanë të drejtën ligjore për tu njohur me të dhënat e tyre, (spitali, gjykata, prokuroria). Pavarësisht faktit se, fëmijët vulnerabël në shumicën e rasteve dallohen prej komunitetit nga karakteristikat e fytyrës dhe sjelljes, të dhënat e tyre personale të shkruara ishin të siguruara. Formulari bazë, i hartuar si një kërkesë e prindit, përmban një formë të shkruar të pëlqimit që prindi jep ose jo psikologut, *për të ndërmarr një vëzhgim/ndërhyrje në sjellje, intervistim dhe/ose shërbime këshillimi me fëmijën në shkollë*, detaj ky që në rrallë shkolla u konstatua.

Si shkelje konstatohet, koha e pacaktuar e mbajtjes së të dhënave sensitive të nxënësve me probleme sociale, nxënësve me probleme të shëndetit mendor, dhe nxënësve problematikë në sjellje. Ky fakt vërehet në të gjitha DAR-et e vendit, ashtu si edhe mosnjohja e ligjit dhe akteve

nënligjore të tij. Udhëzimi nr.4, datë 16.03.2010 i Komisionerit, "Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit" paragrafet 3 dhe 4, detyrojnë kontrolluesin në marrjen e masave të sigurisë, dhe njëkohësisht i rezervon tagrin kontrolluesit për kohën e mbajtjes së të dhënave apo fshirjen e tyre nëse nuk janë të nevojshme.

Në lidhje me rregulloren e miratuar nga MAS, me Nr.4017 datë 02.08.2013, përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se kjo rregullore është e hartuar nga MAS, dhe DAR Lezhë nuk ka të drejtë të ndërhyjë. Megjithatë MAS – i, nuk ju heq të drejtën DAR-ve në vend të hartojnë rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale, ndaj për këtë qëllim ka nxjerrë dhe Udhëzimin Nr.12, datë 27.04.2015, "Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale".

Publikimi i tabelës në portalin e kontrolluesit, ishte një kërkesë e detyrueshme për kontrolluesin, në funksion të neneve 130 dhe 131 të Dispozitave Normative të MAS-it. Rezultatet e mësuesve për testimin profesional dërgohen nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve, ndërsa publikimin e tyre e realizojnë Drejtoritë Rajonale përkatëse, ku mësuesit aplikantë ushtrojnë detyrën e tyre të mësimdhënies.

Zyra e Komisionerit në parim çmon se, publikimi i ID-së unike në faqen e DAR-ve, është i tepërt, pasi mësuesët aplikantë mund të identifikohen qoftë dhe vetëm nëpërmjet një kodi apo ID-je testimi.

DAR Lezhë, po ashtu dhe të gjitha DAR-et në vend, kanë vetëm një adresë zyrtare, për komunikimin elektronik gjatë ushtrimit të detyrës, dhe komunikimi zyrtar kryhet nëpërmjet adresave personale elektronike të punonjësve. Kjo është një shkelje flagrante dhe jo vetëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por dhe për vetë sistemin arsimor në tërësi, pasi komunikimi administrativ zyrtar i kryer nëpërmjet postës elektronike personale të punonjësve, i heq të drejtat kontrolluesit mbi këtë komunikim.

Procesverbali i cili daton në 08.06.2016, u lexua në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët u shprehën se do të përmbushin konstatimet e shprehura në proces verbal dhe do i paraqesin ato në seancën dëgjimore. Pretendime nuk u shprehën.

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, por veçanërisht dhe në mbështetje të Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015, "Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale", duhej të ishin marrë masat e duhura, ato më kryesoret që krijojnë një lloj sigurie dhe ecurie fillestare në mbrojtjen e të dhënave:

- 1- Rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, (pika 19) sipas këtij udhëzimi.
- 2- Deklarata e Konfidencialitetit, (pika 14, gërma “b”), sipas këtij udhëzimi.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, datë 30.04.2015, në datë 19.07.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancë dëgjimore përfaqësuesi i kontrolluesit, paraqiti të formalizuar rregulloren e D.A.R. Lezhë, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe një numër të konsiderueshëm deklaratash konfidencialiteti të nënshkruara nga punonjësit e arsimit parauniversitar të qytetit të Lezhës.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma “dh” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, janë serioze për vetë faktin e gamës së të dhënave sensitive dhe jo sensitive që ky kontrollues mbledh e përpunon. Si të tilla këto shkelje përbëjnë “kundërvajtje administrative”, dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

-dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.”

Kontrolluesi, Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale, kryesisht të subjekteve të të dhënave “nxënës” dhe “mësues”.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 39 paragrafi 1, gërma “dh”. si dhe nenit 39, paragrafi 2 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë, me gjobë në vlerën **30.000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë, me gjobë në vlerën **30.000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë, të realizojë për Zyrat Arsimore të cilat janë në varësi të tij, pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas

Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit, si dhe të shtrijë efektet e rregullores së formalizuar për mbrojtjen e të dhënave personale pranë tyre, brenda një periudhe 3 mujore.

4. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë*, në përputhje me Udhëzimin Nr.4, datë 16.03.2010 të Komisionerit "Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit", paragrafet 3 dhe 4, si dhe në përputhje me kushtet në të cilat ushtron detyrat, të përcaktojnë afatet e mbajtjes të të dhënave personale sensitive, për nxënësit me probleme sociale, nxënësit me probleme të shëndetit mendor, dhe nxënësit problematikë në sjellje.
5. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë*, në përputhje me nenin 5, gërma "c", të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të mos publikojë ID-në personale të mësuesit aplikant.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 29.07.2016

